



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Drenasit
Drejtoria e Inspektionit
Drenas, më 10.01.2019



RAPORT PËR MUAJIN DHJETOR 2018

Gjatë këtij muaji me rëndësi të veçantë janë realizuar inspektime të subjekteve hoteliere rreth respektimit të Ligjit të duhanit si dhe inspektime të Operatorëve Ekonomik në zbatim të urdhëresave nga Ministria e Tregtisë për largimin nga shitja të artikujve që nuk i plotësojnë kriteret për treg.

Në vazhdim po ju sjell punët e kryera nga secili Inspektor sipas sektorëve të tyre përkatëse:

Spektori i Ndërtimit: gjatë këtij muaji kanë inspektuar ndërtimet në Drenas, në veçanti ndërtimet pa leje në zonat e urbanizuara në afërsi të rrugëve regjionale dhe lokale, në zonën e tokës bujqësore nën masën e komosacionit dhe ndërtimet që bëhen në pronë komunale. Mbikqyrja ndaj ndërtimit të lokalit afarist, autostrada: "N9", Komoran, ku janë ndërprerë punimet investitorit i cili ka realizuar punime pa leje, dhe nuk ka zbatuar urdhërin për ndërprerje të punimeve ku edhe ju janë shqiptuar masat kundrejt ligjit.

Gjatë zhvillimit të procedurave, janë hartuar edhe aktvendime për ndërprerje të punimeve, aktvendime për rrënime, urdhëresa për ekzekutime, njoftime dhe përgjigje ndaj kërkesave. Është përcjellur rrënimi i murit të vendosur në rrugë ku ka penguar projektin e asfaltimit të rrugës, në Kishnarekë. Si dhe është shqytuar kërkesa e uzurpimit në lagjen Dervishi në Gradicë.

Spektori i Komunikacionit: ka vazhduar me kontrolla të transportit rrugorë dhe largimin e transportuesve, e me rëndësi të veçantë kontrolla të rendit të udhëtimit të kompanive transportuese të liçencuara. Gjatë këtij muaji është vazhduar me masat e radhës gjatë hasjes në transportues ilegal ku janë shqiptuar 3 gjoba mandatore në vlerë prej 100 € (njëqind euro). Është vërtetuar se mbahen 80 linja të rregullta në transportimin e udhëtarëve në nivelin lokal.

Spektori i Sanitarisë: gjatë këtij muaji është vazhduar me kontrollën e subjekteve afariste hoteliere rreth respektimit të Ligjit për kontrollën e duhanit. Janë inspektuar edhe qendrat e mjeksësisë familjare në Komunën e Drenasit rreth kushteve higjieniko sanitare, për të cilat do të raportohet në veçanti. : Malli me afat të skaduar është konfiskuar për asgjësim dhe pronarit i është shqiptuar gjobë mandatore në vlerë 500€, pasi që i njëjti ka përsëritur shitjen e mallit me afat të skaduar i cili është konfiskuar për asgjësim .

Spektori i Tregut: është vazhduar me kontrollën e tregut javor dhe me urdhëresën nga MTI për kontrollë të Operatorëve Ekonomik rreth verifikimit nëse në treg gjenden produkte lodra për fëmijë që nuk i plotësojnë kriteret për shitje dhe rrezikohen konsumatorët, si dhe nëse gjenden produkte çaji që janë prodhime kopje e Operatorit Ekonomik "Emona" sh.p.k, dhe nëse në treg gjenden produkte të cilat kanë etiketen me përmbajtje "Kosovë/o dhe Metohi", "Kosovo/a-UNMIK" apo "Kosovo/a-Rezoluta 124" apo çdo emërtim tjetër në kundërshtim me emërtimin zyrtar të Republikës së Kosovës. Gjatë këtyre inspektimeve, produktet e gjetura janë evidentuar dhe larguar nga shitja.

Sektori i Ambientit: është vazhduar me inspektime të pronave ku është hedhur material inert sipas kërkeses nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, në të cilat raste pronarët janë urdhëruar për rrafshimin (nivelizimin) e këtij materiali .
Nuk ka pasur kërkesa për pëlqim në ushtrimin e veprimtarisë dhe kërkesa për leje mjedisore .

Në vazhdim është paraqitur pasqyra e punës në shifra për muajin Dhjetor 2018:

Lëmia Inspektuese	Procesverbale	Aktivdime	Urdhër ekzekutimi	Gjoha mandatore	Kërkesa për Pëlqim sanitar	Pëlqime Sanitare	Kërkesa	Shqyrtim i kerk.	Mbyllje të lokaleve	Konfiskim i targave dhe automjeteve	Leje mjedisore
I.sanitar	20	1	-		1	1	2	3	-	-	-
I.Tregut	9	2	-	-	-	-	-	-	-	-	-
I.komunikacionit	16	3	-	3	-	-	-	-	-	-	-
I.Ndërtimit	30	5	2	1	-	-	7	7	-	-	-
I.Ambientit	12	-	-	2	-	-	3	3	-	-	1
Totali	87	11	2	5	1	1	12	13	-	-	1

Janar 2019